

# Projekti i forcimit të rrjetit të transmetimit të KOSTT, Kosovë

## Përmbledhje jo-teknike (PJT)

Procesi i vlerësimit (due diligence) mjedisor dhe social (ESDD):

Projekti për forcimin e rrjetit të transmetimit të KOSTT



OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.  
TRANSMISSION, SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.  
OPERATOR SISTEMA, PRENOSA I TRZIŠTA A.D.





## Informacioni i cilësisë së dokumentit

### Informacion i përgjithshëm

|                          |                                                                                                                                                           |
|--------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Punuar nga</b>        | <b>Environmental Consulting Team L.L.C. (ECT)</b>                                                                                                         |
| <b>Emri i projektit</b>  | <b>Procesi i vlerësimit (due diligence) mjedisor dhe social dhe procedurat e monitorimit për Projektin e forcimit të rrjetit të transmetimit të KOSTT</b> |
| <b>Emri i dokumentit</b> | <b>Përmbledhje Jo-Teknike</b>                                                                                                                             |
| <b>Data</b>              | <b>Shkurt 2026</b>                                                                                                                                        |
| <b>Referencë</b>         | <b>ECT-KOSTT-ESDD-NTS-02/2026</b>                                                                                                                         |

### Adresuesi/ët

|                    |                   |                           |
|--------------------|-------------------|---------------------------|
| <b>Dërguar te:</b> |                   |                           |
| <b>Emri</b>        | <b>Organizata</b> | <b>Dërguar më (data):</b> |
| Emma Sugar         | BERZH             | 14/11/2025                |
| Emma Sugar         | BERZH             | 06/02/2026                |
| Emma Sugar         | BERZH             | 24/02/2026                |
| <b>Kopjo te:</b>   |                   |                           |
| <b>Emri</b>        | <b>Organizata</b> | <b>Dërguar më (data):</b> |
|                    |                   |                           |
|                    |                   |                           |
|                    |                   |                           |

### Historia e modifikimeve

|                 |             |                    |                                      |
|-----------------|-------------|--------------------|--------------------------------------|
| <b>Versioni</b> | <b>Data</b> | <b>Shkruar nga</b> | <b>Miraturar dhe nënshkruar nga:</b> |
| 1               |             |                    |                                      |
| 2               |             |                    |                                      |
|                 |             |                    |                                      |



## Përmbajtja

|                                                                                              |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Akronimet dhe shkurtesat .....                                                               | 4  |
| 1. Përshkrimi i Projektit.....                                                               | 5  |
| 2. Arsyetimi.....                                                                            | 7  |
| 2.1 Lokacionet e projektit .....                                                             | 8  |
| 3. Procesi .....                                                                             | 9  |
| 4. Përfitimet mjedisore, ndikimet negative dhe masat zbutëse.....                            | 10 |
| 4.1 Planifikimi i përdorimit të tokës dhe ndryshimet .....                                   | 10 |
| 4.2 Burimet ujore, ndikimet dhe masat e menaxhimit.....                                      | 10 |
| 4.3 Habitatet, ekologjia dhe ruajtja e natyrës, ndikimet dhe masat e menaxhimit.....         | 11 |
| 4.4 Ndikimet në peizazh dhe në aspektin vizual dhe masat e menaxhimit.....                   | 11 |
| 4.5 Cilësia e ajrit, ndikimet dhe masat e menaxhimit .....                                   | 11 |
| 4.6 Trafiku, zhurma dhe dridhjet, ndikimet dhe masat e menaxhimit.....                       | 11 |
| 4.7 Menaxhimi i mbeturinave .....                                                            | 11 |
| 4.8 Burimi dhe transporti i lëndës së parë, duke përfshirë gropat e përkohshme .....         | 11 |
| 4.9 Siguria rrugore, ndikimet dhe masat e menaxhimit .....                                   | 11 |
| 4.10 Ndikimet e lidhura me infrastrukturën dhe masat e menaxhimit .....                      | 12 |
| 4.11 Ndikimet kumulative (ndikimet e kombinuara me aktivitete të tjera) .....                | 12 |
| 4.13 Çështje të shëndetit dhe sigurisë në punë, duke përfshirë sigurinë e eksplozivëve ..... | 12 |
| 4.14 Ndërprerjet, shëndeti dhe siguria gjatë ndërtimit.....                                  | 12 |
| 4.15 Përputhshmëria me politikat, legjislacionin dhe planet e tjera .....                    | 12 |
| 4.16 Masat zbutëse dhe menaxhimit mjedisor .....                                             | 12 |
| 5. Përfitimet sociale, ndikimet e padëshiruara dhe masat zbutëse .....                       | 13 |
| 5.1 Ndikimet socio-ekonomike .....                                                           | 13 |
| 5.2 Ndikimet në biznese dhe punësim .....                                                    | 13 |
| 5.3 Ndikimet në infrastrukturën ekzistuese dhe shërbimet publike.....                        | 13 |
| 5.4 Ndikimet në trafikun lokal dhe qasjen .....                                              | 13 |
| 5.5 Marrja e tokës dhe zhvendosja .....                                                      | 14 |
| 5.6 Menaxhimi i kontraktorëve dhe akomodimi i punëtorëve.....                                | 14 |
| 5.7 Ndikimet në komunitet .....                                                              | 14 |
| 5.8 Standardet për çështjet e punës .....                                                    | 14 |
| 5.9 Masat e sigurisë dhe shëndetit në rrugët publike .....                                   | 14 |
| 5.10 Çështjet sociale dhe masat zbutëse dhe të menaxhimit.....                               | 15 |
| 5.11 Trashëgimia kulturore .....                                                             | 15 |
| 6 Monitorimi i ndikimeve .....                                                               | 15 |
| 6.1 Procesi i monitorimit .....                                                              | 15 |



|                                                             |    |
|-------------------------------------------------------------|----|
| 6.2 Konsultimi i vazhdueshëm dhe mekanizmat e reagimit..... | 16 |
| 6.3 Adresimi dhe trajtimi i çështjeve të reja.....          | 16 |

## Akronimet dhe shkurtesat

|              |                                                                |
|--------------|----------------------------------------------------------------|
| <b>BE</b>    | Bashkimi Evropian                                              |
| <b>BERZH</b> | Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim                     |
| <b>ECT</b>   | Environmental Consulting Team                                  |
| <b>ESDD</b>  | Procesi i vlerësimit (due diligence) mjedisor dhe social       |
| <b>KDT</b>   | Kontroll i duhur teknik                                        |
| <b>KOSTT</b> | Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Kosovës SH.A. |
| <b>MTA</b>   | Mekanizmi për trajtimin e ankesave                             |
| <b>MVA</b>   | Mega Volt-Amper                                                |
| <b>NS</b>    | Nënstacion                                                     |
| <b>PAPI</b>  | Plani i angazhimit të palëve të interesit                      |
| <b>PCB</b>   | Bifenile të poliklorinuara                                     |
| <b>PMMS</b>  | Plani i menaxhimit mjedisor dhe social                         |
| <b>PPM</b>   | Pajisje personale mbrojtëse                                    |
| <b>PJT</b>   | Përmbledhje jo-teknike                                         |
| <b>PVMS</b>  | Plani i veprimit mjedisor dhe social                           |
| <b>ShSP</b>  | Shëndeti dhe siguria në punë                                   |
| <b>SMMS</b>  | Sistemi i menaxhimit mjedisor dhe social                       |
| <b>TEGj</b>  | Tranzicioni i ekonomisë së gjelbër                             |
| <b>TOR</b>   | Termat e referencës                                            |
| <b>TR</b>    | Transformator                                                  |
| <b>VNM</b>   | Vlerësimi i ndikimit mjedisor                                  |



## 1. Përshkrimi i Projektit

Projekti i Forcimit të Rrjetit të Transmetimit të KOSTT është në zbatim e sipër nga Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT Sh.A.), me financim nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Investimi total vlerësohet të jetë afërsisht 23.25 milionë euro, nga të cilat 22.5 milionë euro do të financohen përmes një kredie sovrane nga BERZH. Programi është pjesë e planit të investimeve kapitale të KOSTT 2024–2027 që synon rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së vjetër të transmetimit dhe sigurimin e besueshmërisë afatgjate të rrjetit, efikasitetit, dhe integritetit të gjenerimit të energjisë së ripërtëritshme.

Projekti përfshin rehabilitimin, përmirësimin dhe zëvendësimin e pajisjeve të tensionit të lartë brenda rrjetit ekzistues të transmetimit 110 kV. Specifikisht përfshihen:

- Rehabilitimi dhe modernizimi i nënstacioneve 110/10 (20) kV në Klinë dhe Burim, duke përfshirë zëvendësimin e transformatorëve, zbarrave dhe sistemeve të kontrollit.
- Rivitalizimi i nënstacioneve Vushtri 1 dhe Vallaq, duke përfshirë fushat e linjave 110 kV, sistemin e zbarrave dhe reletë mbrojtëse.
- Ndërrimi ose shtimi i transformatorëve në Gjilan 5 (TR2 i ri 110/10 (20) kV – 40 MVA), Viti , Gjakova 1 dhe 2, Gjilan 1, Vushtri 1, Prishtinë 1 (transformator trepshtjellor 110/35/10(20) kV me fuqi 63/63/63), Skenderaj, dhe Prizren 3.
- Linja Prizren 1 dhe Prizren 2: ndërtimi i përçuesit nëntokësor 110 kV me qark të vetëm prej 5.2 km, duke zëvendësuar linjën ekzistuese me qark të vetëm dhe duke ndërtuar një fushë (bay) të re.
- Linja Prizren 1 dhe Prizren 3: zëvendësimi i përçuesve ekzistues me përçues modernë të tipit ACSR HW 170 mm<sup>2</sup>, me qëllim rritjen e kapacitetit bartës të rrymës dhe uljen e humbjeve teknike.

Pas funksionalizimit, të gjitha objektet do të mbeten nën pronësinë dhe kontrollin operativ të KOSTT-it. Operimi dhe mirëmbajtja rutinore do të ndjekin Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, Shëndetësor dhe Sigurisë të KOSTT-it, në përputhje me parimet ISO 14001 dhe 45001. Mirëmbajtja parandaluese do të përfshijë:

- Testimi periodik i vajrave të transformatorëve dhe përmbajtjes së PCB-ve.
- Inspektimi dhe pastrimi i baseneve mbrojtëse (bunds), separatorëve dhe sistemeve të drenazhimit.
- Monitorimi i rrjedhjeve të gazit SF<sub>6</sub>, niveleve të zhurmës dhe ekspozimit ndaj fushave elektromagnetike.
- Kalibrim i rregullt i sistemeve të mbrojtjes, kontrollit dhe sistemit SCADA.

Ekipet e mirëmbajtjes do të trajnohen dhe pajisen me PMP dhe materiale të përshtatshme për reagim ndaj derdhjeve. Të gjitha vajrat e përdorura, bateritë dhe materialet e mbeturinave do të menaxhohen përmes kontraktorëve të licencuar, në përputhje me procedurat e menaxhimit të mbeturinave të KOSTT dhe legjislacionin kombëtar mjedisor. Në përgjithësi, projekti do të rivendosë besueshmërinë, do të forcojë qëndrueshmërinë e rrjetit ndaj stresit klimatik dhe do të krijojë kapacitete të mjaftueshme për integrimin e deri në 300 MW të kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtëritshme në sistemin e transmetimit të Kosovës.

Të gjitha punimet janë të vendosura brenda nënstacioneve ekzistuese (brownfield) ose përgjatë korridoreve të vendosura të shërbimit (right-of-way), pa kërkuar shpronësime apo marrje të re të tokës. Aktivitetet e ndërtimit do të zbatohen në përputhje me sistemet dhe protokollet standarde të menaxhimit të mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë (SHSP) dhe nën mbikëqyrjen e KOSTT-it.

Projekti klasifikohet si Kategoria B sipas Politikës Mjedisore dhe Sociale (2019) të BERZH, duke kërkuar një vlerësim të duhur mjedisor dhe social (ESDD) në përputhje me natyrën dhe shkallën e ndikimeve.




Figura 1Harta e Projektit (Studimi i fizibilitetit dhe analiza teknike e duhur për rinovimin e rrjetit dhe prokurimin e transformatorëve të rrjetit - Raporti përfundimtar, Nëntor 2025)



## 2. Arsyetimi

Rrjeti i transmetimit në Kosovë po hyn në një fazë të përfundimit të synuar, me qëllim adresimin e rritjes së kërkesës, zëvendësimin e aseteve të amortizuara dhe krijimin e kapaciteteve për integrimin e energjisë së ripërtëritshme. KOSTT, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, menaxhon rrjetet 110 kV dhe 220 kV dhe është përgjegjës për stabilitetin e sistemit dhe operimin e tregut të energjisë elektrike. Shumë nga nënstacionet dhe linjat janë ndërtuar midis viteve 1960 dhe 1980 dhe aktualisht përballen me sfida në aspektin e besueshmërisë dhe sigurisë, për shkak të projektimit të vjetëruar, korrozionit dhe nivelit të kufizuar të automatizimit. Projekti synon modernizimin e nënstacioneve dhe linjave të transmetimit në të gjithë Kosovën për të rikthyer kriterin e besueshmërisë N-1, për të reduktuar humbjet teknike, për të përmirësuar qëndrueshmërinë e rrjetit dhe për të mundësuar integrimin e deri në 300 MW kapacitete të reja të energjisë së ripërtëritshme. Ai është pjesë e Planit të Investimeve Kapitale të KOSTT për vitet 2024-2027 dhe bashkëfinancohet nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Projekti zbatohet në përputhje me kuadrin ligjor mjedisor dhe social të Kosovës, i cili është i harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian. Ligjet përkatëse përfshijnë Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit (Nr. 03/L-025), Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr. 08/L-181), Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233), Ligjin për Mbeturinat (Nr. 08/L-071), Ligjin për Ujërat e Kosovës (Nr. 04/L-147), Ligjin për Mbrojtjen nga Zhurma (Nr. 02/L-102) dhe Ligjin për Ndryshimet Klimatike (Nr. 08/L-250). Në aspektin social, zbatohen Ligji i Punës (Nr. 03/L-212), Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (Nr. 04/L-161) dhe Ligji për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme (Nr. 03/L-139). Kosova është palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe e përafron legjislacionin e saj me direktivat kryesore mjedisore të BE-së, duke përfshirë Direktivën e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor (2011/92/BE), Direktivën Kornizë për Mbeturinat (2008/98/KE) dhe Direktivën Kornizë për Ujin (2000/60/KE).

Të gjitha punimet do të zhvillohen në nënstacionet ekzistuese dhe brenda korridoreve të përcaktuara të shërbimit (right-of-way). Kjo qasje në zona të zhvilluara (brownfield) minimizon ndikimet mjedisore dhe sociale. Çështjet kryesore mjedisore në nënstacionet ekzistuese lidhen me menaxhimin e vajrave të transformatorëve, rreziqet e mundshme nga ndotja e trashëguar me bifenile të poliklorinuara (PCB) dhe funksionimin e paplotë ose joefikas të seperatorëve vaj-ujë. Shumë nënstacione nuk kanë sisteme sekondare të mbrojtjes nga kontaminimi dhe kërkojnë përmirësime për funksionim të sigurt. Asnjë nga lokacionet e projektit nuk ndodhet brenda ose afër zonave të mbrojtura. Përdorimi i tokës përreth është i përzier urban, industrial dhe bujqësor, pa habitate kritike. Cilësia e ajrit dhe e ujit ndikohet nga aktivitetet lokale dhe mbetet brenda standardeve kombëtare, ndërsa ndikimet e zhurmës dhe ato vizuale janë të përkohshme dhe të kufizuara në aktivitetet e ndërtimit.

Në aspektin social, zonat e projektit përfshijnë komunat: Prishtinë, Klinë, Istog, Vushtrri, Zubin Potok, Skënderaj, Gjakovë, Gjiilan, Viti dhe Prizren. Këto zona karakterizohen nga dendësi mesatare e popullsisë dhe mënyra të përziera jetese, të bazuara në bujqësi, tregti dhe shërbime. Projekti nuk do të shkaktojë zhvendosje fizike dhe as kufizim të përdorimit të tokës, ndërsa gjatë fazës së ndërtimit do të krijojë mundësi punësimi afatshkurtra. Komunitetet do të përfitojnë nga përmirësimi i stabilitetit të rrjetit, reduktimi i ndërprerjeve të energjisë elektrike dhe rritja e mundësive për integrimin e energjisë së ripërtëritshme.

Nënstacionet e identifikuar për rehabilitim janë përzgjedhur përmes analizës së rrjetit të KOSTT-it dhe planit dhjetëvjeçar të zhvillimit, i cili nxori në pah kufizimet e besueshmërisë dhe humbjet e larta teknike. Shumica e nënstacioneve janë ndërtuar ndërmjet viteve 1960 dhe 1980, me disa, si Gjilani 5 dhe Vitia, janë ndërtuar në periudhë më të vonshme.

Vlerësimi i duhur mjedisor dhe social (ESDD) ka analizuar dy alternativa kryesore. E para, alternativa “mosveprim”, do të mbështetej vetëm në mirëmbajtjen rutinë dhe do të rezultonte në degradim të vazhdueshëm të infrastrukturës, rritje të humbjeve teknike dhe shtim të rreziqeve mjedisore nga rrjedhjet dhe derdhjet. E dyta, zbatimi i projektit, përfshin rehabilitimin e synuar të nënstacioneve, zëvendësimin e transformatorëve të vjetëruar dhe përmirësimet në korridorin e transmetimit në Prizren. Kjo alternativë siguron përmirësim të besueshmërisë



operacionale, rritje të sigurisë dhe përmirësim të performancës mjedisore përmes sistemeve të projektimit për mbajtje të sigurt, instalimit të separatorëve të rinj vaj-ujë, masave për parandalimin e derdhjeve dhe sistemeve moderne të kontrollit. Gjithashtu, kjo alternativë siguron pajtueshmëri me standardet kombëtare mjedisore dhe sociale dhe të BERZH-it, duke mbështetur tranzicionin e Kosovës drejt një sistemi energjetik më të qëndrueshëm dhe me pjesëmarrje më të lartë të burimeve të ripërtëritshme.

## 2.1 Lokacionet e projektit

Projekti do të zbatohet në disa nënstacione dhe linja të transmetimit ekzistuese brenda Kosovës, duke përfshirë lokacionet e mëposhtme:

- NS Klinë (42.62866N, 20.59674E)
- NS Burim (42.7820917N, 20.5288679E)
- NS Vushtrri 1 (42.82266N, 20.94240E)
- NS Gjilan 1 (42.472532N, 21.481531E)
- NS Gjilan 5 (42.4644167N, 21.4388056E)
- NS Gjakovë 1 (42.3944722N, 20.4334444E)
- NS Gjakovë 2 (42.3664444N, 20.4617778E)
- NS Viti (42.318420N, 21.383359E)
- NS Prizren 1 (42.2206111N, 20.7234167E)
- NS Prizren 2 (42.232336N, 20.668603E)
- NS Prizren 3 (42.226067N, 20.751050E)
- NS Skënderaj (42.7570556N, 20.7885000E)
- NS Prishtina 1 (42.64494N, 21.13566E)
- NS Vallaq (42.928271N, 20.823565E)

Këto nënstacione përfaqësojnë një kyçe në rrjetin e transmetimit 110 kV dhe 220 kV. Të gjitha lokacionet janë në pronësi dhe operim të KOSTT SH.A. dhe ndodhen në parcela ekzistuese ose brenda korridoreve të përcaktuara të shërbimit, çka nënkupton se projekti përfshin përmirësime dhe zëvendësime, e jo ndërtim të ri në zona të paprekura (greenfield). Duke synuar këtë shpërndarje të nënstacioneve në veri, lindje dhe perëndim të Kosovës, investimi do të mbështesë rritjen e besueshmërisë së sistemit, uljen e humbjeve teknike dhe përmirësimin e integritetit të kapaciteteve të energjisë së ripërtëritshme në rrjetin kombëtar.




Figura 2 Harta e vendeve të zbatimit të Projektit



### 3. Procesi

Për projektin e përforsimit të rrjetit të transmetimit të KOSTT Sh.a. është përgatitur një vlerësim mjedisor dhe social, me qëllim përmbushjen e kërkesave të Politikës Mjedisore dhe Sociale (2019) dhe Kërkesave specifike të Performancës (KP) të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe të legjislacionit kombëtar mjedisor të Kosovës.

Projekti nuk i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të plotë të ndikimit në mjedis sipas legjislacionit të Kosovës, duke qenë se ndërhyrjet parashihen brenda zonave ekzistuese (brownfield). Vlerësimi Mjedisor dhe Social është hartuar në përputhje me parimet dhe metodologjinë e direktivës së BE-së për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (2011/92/BE e ndryshuar nga 2014/52/BE). Procesi respekton kërkesat për shqyrtim mjedisor (screening), identifikim të ndikimeve të mundshme me rëndësi, analizë të alternativave dhe përcaktim të masave zbutëse. Legjislacioni mjedisor i Kosovës, konkretisht Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr. 08/L-181), është në përputhje me Direktivën e BE-së për VNM-në dhe përcakton procedurat e shqyrtimit dhe përcaktimit të fushëveprimit në përputhje me ato të Bashkimit Evropian. Në kuadër të ESDD-së është analizuar sistemi kombëtar dhe është konstatuar se ai garanton transparencë, pjesëmarrje të publikut dhe publikim të informacionit mjedisor në përputhje me standardet e BE-së.

Angazhimi i palëve të interesit është zhvilluar në përputhje me kërkesën për performancë me nr. 10 (KP10) të BERZH-për publikimin e informacionit dhe angazhimin e palëve të interesit. Konsultimet janë zhvilluar me departamentet e KOSTT-it, operatorët e nënstacioneve dhe ekipin e vlerësimit, me fokus në kushtet ekzistuese në terren, çështjet e sigurisë dhe përfitimet e pritshme si dhe ndikimet e mundshme të projektit.

KOSTT do të publikojë përmbledhjen jo-teknike dhe planin e angazhimit të palëve të interesit në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Këto dokumente do të jenë të disponueshme në faqen zyrtare të KOSTT dhe në formë të shtypur në zyrat komunale në zonat përkatëse të projektit, për një periudhë prej 30 ditësh. Gjatë kësaj periudhe, palët e interesit mund të paraqesin komente ose kundërshtime në mënyrë elektronike, me shkrim ose personalisht në pikat e përcaktuara të kontaktit. Dokumentet do të jenë gjithashtu të disponueshme në faqen zyrtare të BERZH-it.



## 4. Përfitimet mjedisore, ndikimet negative dhe masat zbutëse

Projekti do të sjellë përfitime të konsiderueshme mjedisore dhe operacionale përmes modernizimit të rrjetit të transmetimit të Kosovës dhe rritjes së sigurisë dhe besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike. Njëkohësisht, gjatë fazës së ndërtimit dhe mirëmbajtjes priten ndikime të përkohshme dhe specifike për secilin lokacion, si në aspektin mjedisor ashtu edhe social. Këto ndikime mund të menaxhohen në mënyrë efektive përmes zbatimit të planit të veprimit mjedisor dhe social, si dhe në përputhje me sistemin e menaxhimit të mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë të KOSTT.

Projekti i Forcimit të Rrjetit të Transmetimit KOSTT do të përmirësojë ndjeshëm performancën mjedisore dhe operacionale të rrjetit të tensionit të lartë të Kosovës. Përmes zëvendësimit të transformatorëve të vjetëruar dhe me rrjedhje, rehabilitimit të nënstacioneve dhe përmirësimit të korridorit të transmetimit në Prizren, projekti do të reduktojë humbjet teknike, do të rrisë besueshmërinë e sistemit dhe do të krijojë kapacitete për integrimin e energjisë së ripërtëritshme. Këto ndërhyrje do të kontribuojnë gjithashtu në eliminimin e burimeve të ndotjes së trashëguar, në uljen e rrezikut nga rrjedhjet e vajit dhe në vendosjen e sistemeve moderne për parandalimin e derdhjeve, sigurinë kundër zjarrit dhe monitorimin operacional.

Ndikimet negative pritet të jenë të përkohshme dhe të lokalizuara, kryesisht të lidhura me aktivitetet e ndërtimit, të tilla si zhurma, pluhuri, ndërprerjet e kufizuara të trafikut dhe trajtimi i mbetjeve të rrezikshme dhe vajrave të transformatorëve. Rreziqet e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe në komunitet do të menaxhohen përmes mbikëqyrjes së rreptë dhe pajtueshmërisë me standardet e BERZH-it dhe ato kombëtare.

Masat zbutëse përfshijnë instalimin e seperatorëve vaj-ujë dhe sistemeve të mbajtjes me basene mbrojtëse, menaxhimin e duhur të vajrave me dhe pa PCB, përmirësimin e sistemeve të zbulimit dhe shuarjes së zjarrit, mbrojtjen e biodiversitetit përmes vendosjes së shënuesve për shpendë në linja, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të rrjedhjeve, mbeturinave dhe shkarkimeve. Pas zbatimit të këtyre masave, ndikimet e mbetura do të jenë të vogla dhe projekti do të rezultojë në një rezultat pozitiv neto mjedisor, duke kontribuar në një infrastrukturë energjetike më të pastër, më të sigurt dhe më të qëndrueshme në Kosovë.

Pas zbatimit, projekti pritet të zvogëlojë humbjet teknike me afërsisht 1.5 përqind në të gjithë rrjetin 110 kV, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit operacional dhe duke mbështetur lidhjen e deri në 300 MW të burimeve të reja të energjisë së ripërtëritshme.

### 4.1 Planifikimi i përdorimit të tokës dhe ndryshimet

Të gjitha punimet e projektit ndodhen brenda nënstacioneve ekzistuese të KOSTT ose përgjatë korridoreve të përcaktuara të linjave të transmetimit. Megjithatë nuk parashikohet shpronësim në shkallë të gjerë, projekti mund të përfshijë marrje të kufizuar dhe të përkohshme të tokës, si dhe zhvendosje të vogla ekonomike.

### 4.2 Burimet ujore, ndikimet dhe masat e menaxhimit

Ndikime të mundshme në cilësinë e ujit mund të ndodhin si pasojë e rrjedhjeve aksidentale të vajit të transformatorëve ose shkarkimit të papërshtatshëm të ujërave gjatë fazës së ndërtimit. Punimet e rehabilitimit do të përfshijnë instalimin e seperatorëve vaj-ujë, sistemeve të rrethimit dhe kullimit të përmirësuar për të parandaluar kontaminimin e ujërave sipërfaqësore ose nëntokësore. Gjatë operimit, të gjitha rrjedhjet me përmbajtje vajore do të kalojnë përmes sistemeve të mbajtjes përpara shkarkimit. Inspektimi dhe pastrimi i rregullt i kanaleve të kullimit/drenazhimit do të jenë pjesë e planit të mirëmbajtjes së KOSTT.



### 4.3 Habitatet, ekologjia dhe ruajtja e natyrës, ndikimet dhe masat e menaxhimit

Nënstacionet dhe korridoret e transmetimit ndodhen në zona të modifikuara tashmë nga aktiviteti njerëzor dhe nuk nuk bien ndesh me asnjë zonë të mbrojtur ose habitat kritik. Pastrimi i bimësisë do të jetë minimal dhe i kufizuar në mirëmbajtjen e korridoreve ekzistuese. Nuk priten ndikime të drejtpërdrejta në jetën e egër ose në habitatet e ndjeshme. Nëse gjatë ndërtimit hasen fauna si zogj ose gjitarë të vegjël, punimet do të rregullohen përkohësisht për të shmangur dëmin.

### 4.4 Ndikimet në peizazh dhe në aspektin vizual dhe masat e menaxhimit

Duke pasur parasysh natyrën e projektit në zona ekzistuese (brownfield), ndikimet vizuale pritet të jenë të vogla. Zëvendësimi i transformatorëve dhe vendosja nëntokësore e linjës Prizren 1 deri në Prizren 2 do të zvogëlojë ndërhyrjen vizuale krahasuar me konfigurimin ekzistues. Aktivitetet e ndërtimit mund të shkaktojnë shqetësime të përkohshme vizuale për shkak të pranisë së makinerive dhe magazinimit të materialeve, të cilat do të zbuten duke kufizuar orarin e punës, duke ruajtur pastërtinë e vendit dhe duke hequr menjëherë mbeturinat e ndërtimit.

### 4.5 Cilësia e ajrit, ndikimet dhe masat e menaxhimit

Emetimet në ajër gjatë fazës së ndërtimit do të rezultojnë kryesisht nga funksionimi i makinerive, transporti i materialeve dhe gjenerimi i pluhurit. Këto ndikime do të jenë të përkohshme dhe të lokalizuara. Masat zbutëse do të përfshijnë ujitjen e rregullt të rrugëve të hyrjes, mbulimin e rezervave të materialeve dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe makinerive për të minimizuar emetimet e shkarkimeve. Nuk priten ndikime të rëndësishme në cilësinë e ajrit gjatë fazës së operimit.

### 4.6 Trafiku, zhurma dhe dridhjet, ndikimet dhe masat e menaxhimit

Gjatë ndërtimit, pranë nënstacioneve do të ketë rritje të përkohshme të niveleve të trafikut dhe zhurmës. Këto do të zbuten nëpërmjet planeve të menaxhimit të trafikut, planifikimit të shpërndarjes së materialeve për të shmangur orët e pikut dhe kufizimit të aktiviteteve të zhurmshme vetëm gjatë ditës. Nuk priten ndikime nga dridhjet për shkak të shkallës së kufizuar të punimeve civile. Zhurma operative nga transformatorët do të mbetet brenda kufijve kombëtarë dhe të BE-së, ndërsa do të realizohet monitorim i rregullt.

### 4.7 Menaxhimi i mbeturinave

Rrjedhat e mbeturinave do të përfshijnë mbeturina ndërtimi, skrap metali, materiale paketimi dhe sasi të vogla të mbeturinave të rrezikshme, siç janë vaji i përdorur, bateritë dhe mbetjet e PCB-ve nga transformatorët e vjetër. Të gjitha mbeturinat do të ndahen dhe do të ruhen në zona të caktuara para se të transferohen tek kompanitë e licencuara. Mbeturinat e rrezikshme do të menaxhohen në përputhje me procedurat e KOSTT-it për menaxhimin e mbeturinave dhe Ligjin për mbeturinat.

### 4.8 Burimi dhe transporti i lëndës së parë, duke përfshirë gropat e përkohshme

Projekti nuk përfshin nxjerrjen e lëndëve të para ose krijimin e gropave të përkohshme. Materialet e ndërtimit, të tilla si agregatët, betoni dhe kanalet e kablove, rekomandohet të sigurohen nga furnizues të licencuar në Kosovë. Rrugët e transportit do të bien dakord me autoritetet komunale për të minimizuar shqetësimin e komunitetit dhe dëmtimit të infrastrukturës rrugore.

### 4.9 Siguria rrugore, ndikimet dhe masat e menaxhimit

Automjetet e ndërtimit dhe furnizimet me materiale mund të rrisin përkohësisht trafikun në rrugët lokale. Rreziqet e sigurisë rrugore do të kontrollohen nëpërmjet angazhimit të shoferëve të trajnuar, përdorimit të automjeteve të



shënuara qartë dhe koordinimit me autoritetet komunale të trafikut. Shenjat paralajmëruese do të vendosen pranë vendeve të ndërtimit dhe qasja në nënstacione do të kufizohet vetëm për personelin e autorizuar.

#### 4.10 Ndikimet e lidhura me infrastrukturën dhe masat e menaxhimit

Nuk parashihen objekte të palëve të treta të ndikuara përtej nënstacioneve ekzistuese dhe korridoreve të transmetimit në Prizren. Rugët e përkohshme të qasjes do të ndjekin rrugët ekzistuese. Nuk priten ndikime në infrastrukturën e palëve të treta. Koordinimi me komunat dhe ndërmarrjet publike do të sigurojë mbrojtjen e infrastrukturës gjatë realizimit të punimeve.

#### 4.11 Ndikimet kumulative (ndikimet e kombinuara me aktivitete të tjera)

Ndikimet kumulative janë të kufizuara për shkak të shkallës së vogël dhe natyrës së shpërndarë të komponentëve të projektit. Efekte të vogla kumulative mund të shfaqen në Prizren, ku disa nënstacione dhe ndërtimi i linjës nëntokësore do të realizohen njëkohësisht. Këto do të menaxhohen përmes një planifikimi të koordinuar dhe respektimit të masave zbutëse për menaxhimin e zhurmës, pluhurit dhe mbeturinave.

Projekti do të mbështesë në mënyrë indirekte rritjen e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme dhe ndërlidhjen rajonale, të cilat mund të kontribuojnë në përfitime afatgjata mjedisore. Bazuar në informacionin aktualisht të disponueshëm, nuk janë identifikuar zhvillime të reja të mëdha në domenin publik që do të rezultojnë në ndikime të konsiderueshme kumulative mjedisore ose sociale në lidhje me projektin, dhe nuk janë shpallur zyrtarisht linja të reja transmetimi ajrore ose infrastrukturë shoqëruese që do të lidheshin me nënstacionet sipas këtij plani investimi. Nuk parashikohen ndikime të rëndësishme negative të shkaktuara.

#### 4.13 Çështje të shëndetit dhe sigurisë në punë, duke përfshirë sigurinë e eksplozivëve

Aktivitetet e ndërtimit paraqesin rreziqe që lidhen me punën në lartësi, sigurinë elektrike dhe përdorimin e makinerive të rënda. Kontraktorët do të përgatisin dhe zbatojnë plane të shëndetit dhe sigurisë specifike për secilin lokacion, duke përfshirë trajnimin, pajisjet mbrojtëse personale dhe procedurat e reagimit ndaj emergjencave. Nuk parashikohet të përdoren eksplozivë për këtë projekt.

#### 4.14 Ndërprerjet, shëndeti dhe siguria gjatë ndërtimit

Shqetësime afatshkurtra për banorët përreth mund të rezultojnë nga zhurma, pluhuri dhe lëvizjet e trafikut gjatë fazës së ndërtimit. Këto ndikime do të zbuten përmes kufizimit të punimeve në orarin ditor, mbajtjes së komunikimit të vazhdueshëm me autoritetet lokale dhe vendosjes së sinjalistikës së përshtatshme dhe kontrollit të qasjes në kantiere.

#### 4.15 Përputhshmëria me politikat, legjislacionin dhe planet e tjera

Projekti është në përputhje me strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës 2022–2031 dhe me planin kombëtar për energji dhe klimë. Në nivel strategjik, programi i investimeve është në përputhje me objektivat kombëtare të zhvillimit të energjisë dhe rrjetit për sigurinë e furnizimit, uljen e humbjeve dhe integrimin e energjisë së ripërtëritshme. Brenda KOSTT-it, nënstacionet, transformatorët dhe seksionet e linjave të përfshira në projekt përbëjnë pjesë të programit të tij të investimeve kapitale për periudhën 2024–2027 dhe përbëjnë ndërhyrje prioritare në rrjetin e transmetimit. Është e rëndësishme të përmendet se projekti kontribuon në qasjen e BERZH-it për Tranzicionin drejt Ekonomisë së Gjelbër (TEGj) duke mbështetur dekarbonizimin e sektorit energjetik në Kosovë përmes përmirësimeve në rrjet që lehtësojnë integrimin e energjisë së ripërtëritshme.

#### 4.16 Masat zbutëse dhe menaxhimit mjedisor

Një grup i plotë masash menaxhuese dhe zbutëse sociale është përcaktuar në kuadër të planit të veprimit mjedisor dhe social (PVMS) të, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me kuadrin ligjor të Kosovës dhe me kërkesat për performancë (KP) të BERZH-it. Ai përfshin masa për mbrojtjen e mjedisit, shëndetin dhe sigurinë,



menaxhimin e mbeturinave, parandalimin e ndotjes dhe angazhimin e palëve të interesit, për të siguruar që projekti do të zbatohet në përputhje me KP-të e BERZH-it. KOSTT do të zbatojë PVMS-në përmes Sistemit të tij të Menaxhimit Mjedisor, Shëndetësor dhe të Sigurisë dhe do të monitorojë pajtueshmërinë përmes inspektimeve të rregullta dhe raportimit të BERZH-i. Nuk kërkohen masa kompensuese, pasi nuk priten ndikime të konsiderueshme të mbetura pas masave zbutëse. Projekti pritet të rezultojë në përfitime të përgjithshme mjedisore dhe sociale, përmes rritjes së efikasitetit, uljes së humbjeve teknike dhe përmirësimit të integritetit të energjisë së ripërtëritshme.

## 5. Përfitimet sociale, ndikimet e padëshiruara dhe masat zbutëse

Projekti do të sjellë përfitime të konsiderueshme sociale dhe ekonomike përmes përmirësimit të besueshmërisë së furnizimit me energji, mbështetjes së punësimit lokal dhe rritjes së sigurisë së përgjithshme të infrastrukturës.

### 5.1 Ndikimet socio-ekonomike

Projekti mund të mbështesë zhvillimin ekonomik lokal duke gjeneruar punësim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë si gjatë ndërtimit, ashtu edhe në një masë më të kufizuar gjatë fazave të funksionimit. Përparësi do t'i jepet fuqisë punëtore lokale dhe furnizuesve. Parimet e barazisë gjinore do të integrohen gjatë gjithë zbatimit të projektit, duke siguruar qasje të barabartë për gratë dhe burrat në mundësitë e punësimit dhe trajnimit, duke marrë në konsideratë nevojat specifike gjinore në mjediset e vendit të punës dhe masat e sigurisë. Kjo do të jetë në përputhje me Strategjinë e Barazisë Gjinore të BERZH-it.

Ndikimet e mundshme negative socio-ekonomike janë kryesisht të përkohshme dhe lidhen me shqetësimet gjatë ndërtimit, të tilla si zhurma, rritja e trafikut të automjeteve të rënda dhe ndërprerja e përkohshme e rrugëve lokale të qasjes.

### 5.2 Ndikimet në biznese dhe punësim

Duke forcuar rrjetin kombëtar të transmetimit, projekti do t'u sjellë dobi industrive ekzistuese dhe do të promovojë investime të reja përmes përmirësimit të besueshmërisë së furnizimit me energji elektrike. Nënstacionet e vendosura pranë zonave rezidenciale ose komerciale (siç janë Prizreni 1, Gjilani 1, Gjakova 1, Skenderaj dhe Prishtina 1) mund të përballen me shqetësime afatshkurtra për shkak të zhurmës nga ndërtimi ose kufizimeve të përkohshme të qasjes. Këto ndikime do të minimizohen përmes planifikimit të kujdesshëm të punimeve dhe njoftimit paraprak të palëve të prekura. Në planin afatgjatë, përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve pritet të kontribuojë në përmirësimin e kushteve ekonomike lokale.

### 5.3 Ndikimet në infrastrukturën ekzistuese dhe shërbimet publike

Punimet civile dhe elektrike brenda nënstationeve ekzistuese dhe përgjatë rrugëve të qasjes mund të shkaktojnë ndërprerje afatshkurtra në rrjetin lokal rrugor ose në infrastrukturën e shërbimeve publike. Koordinimi i vazhdueshëm me komunat dhe ofruesit e shërbimeve do të sigurojë që çdo infrastrukturë e prekur të restaurohet pa vonesë, duke ruajtur qasje të sigurt dhe të pandërprerë për publikun.

### 5.4 Ndikimet në trafikun lokal dhe qasjen

Gjatë fazës së ndërtimit, lëvizja e automjeteve të rënda dhe pajisjeve, në veçanti për transportin e transformatorëve dhe hapjen e kanaleve për kablo, mund të ndikojë përkohësisht në trafikun dhe sigurinë rrugore në disa zona si Prizren, Gjakovë dhe Gjilan. Do të zbatohet një plan i detajuar për menaxhimin e trafikut (PMT), i cili do të përfshijë masa si kufizimi i transportit gjatë orëve të pikut, respektimi i kufizimeve të shpejtësisë



pranë vendbanimeve, vendosja e sinjalistikës së qartë paralajmëruese dhe angazhimi i personelit të trajnuar për orientimin e trafikut dhe garantimin e sigurisë.

## 5.5 Marrja e tokës dhe zhvendosja

Punimet janë planifikuar kryesisht brenda nënstacioneve ekzistuese dhe korridoreve të transmetimit, prandaj nuk parashikohet zhvendosje fizike apo shpronësim i tokës. Nëse në faza të mëvonshme do të kërkohet tokë shtesë, procesi do të menaxhohet në përputhje me kërkesën për performancë 5 (Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme) të BERZH, si dhe do të ndërlidhet me çdo plan të zhvendosjes që mund të hartohet për projektin.

Traseja e ardhshme e linjës nëntokësore ndërmjet Prizren 1 dhe Prizren 2 ende nuk është finalizuar. Gjatë verifikimit në terren është konstatuar se traseja e propozuar kalon pjesërisht përgjatë rrugës ekzistuese dhe pjesërisht mbi tokë bujqësore.

## 5.6 Menaxhimi i kontraktorëve dhe akomodimi i punëtorëve

Projekti është i shpërndarë gjeografikisht, me aktivitete ndërtimi të përqendruara në nënstacionet ekzistuese. Duke pasur parasysh afërsinë me zonat urbane dhe periurbane, nuk parashikohet krijimi i kampeve të mëdha të dedikuara për punëtorët.

KOSTT do të zhvillojë një procedurë për menaxhimin e kontraktorëve, e cila do të përfshihet në të gjitha dokumentet e tenderimit. Kjo do t'i detyrojë kontraktorët të përmbushin të gjitha ligjet kombëtare të punës, kërkesat e BERZH-it (KP 2 dhe 4) dhe SMMS-në e projektit, duke përfshirë standardet për mosdiskriminim, shëndetin dhe sigurinë në punë (ShSP) dhe kushtet e drejta të punës.

## 5.7 Ndikimet në komunitet

Nuk është identifikuar ndonjë komunitet specifik, përfshirë komunitetet rome, të cilët janë pronarë apo në përdorim të tokës së prekur nga projekti. Banorët e afërt, veçanërisht në Prizren 1, Prizren 3, Gjilan 1, Gjakovë 1 dhe Skënderaj, mund të përjetojnë shqetësime të përkohshme nga punimet e ndërtimit. Banorët dhe bizneset lokale do të mbahen të informuar rreth aktiviteteve të projektit përmes përditësimeve dhe konsultimeve të rregullta. Angazhimi me komunitetin do të mbahet gjatë gjithë fazave të ndërtimit dhe rehabilitimit për të siguruar që shqetësimet e mundshme të minimizohen dhe shqetësimet të adresohen menjëherë.

## 5.8 Standardet për çështjet e punës

Të gjithë punëtorët e projektit, qoftë të punësuar drejtpërdrejt nga KOSTT apo përmes kontraktorëve, do të angazhohen sipas kushteve në përputhje me ligjin e punës të Kosovës dhe kërkesën e performancës 2 të BERZH-it. Kjo përfshin të drejtën për kontrata formale, mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim, paga të drejta, orar të rregulluar pune dhe mbrojtje nga puna e fëmijëve apo puna e detyruar.

KOSTT dhe kontraktorët e tij duhet të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar të punës dhe standardet ndërkombëtare, duke përfshirë KP2 të BERZH-it.

## 5.9 Masat e sigurisë dhe shëndetit në rrugët publike

Lëvizja e transportit të pajisjeve të rënda gjatë dorëzimit të transformatorëve mund të paraqesë rreziqe për trafikun dhe sigurinë. Masat parandaluese do të përfshijnë kufizime të shpejtësisë, vendosje të sinjalistikës së dukshme rrugore dhe planifikim të transportit jashtë orëve të pikut. Ngarkesat me përmasa të mëdha do të shoqërohen nga personel i trajnuar ose nga autoritetet lokale, me qëllim garantimin e sigurisë për publikun dhe punëtorët.



## 5.10 Çështjet sociale dhe masat zbutëse dhe të menaxhimit

Plani i veprimit mjedisor dhe social (PVMS) përfshin masa të hartuara për të parandaluar, minimizuar apo kompensuar ndikimet e mundshme negative sociale dhe për të rritur përfitimet sociale për punëtorët, komunitetet dhe palët e tjera të interesit.

Planet specifike të menaxhimit dhe zbutjes sociale përfshijnë:

- Plani i angazhimit të palëve të interesit (PAPI) - përcakton një proces të vazhdueshëm për publikimin e informacionit, konsultimin dhe pjesëmarrjen e palëve të interesit gjatë gjithë ciklit të projektit.
- Planet për menaxhimin e kontraktorëve dhe punës - kontraktorët do të jenë të detyruar të respektojnë legjislacionin kombëtar të punës dhe KP2 të BERZH-it. Planet do të sigurojnë kushte të drejta pune, mundësi të barabarta, lehtësira për mirëqenien e punëtorëve dhe parandalimin e ngacmimit ose diskriminimit. Trajnimi, përdorimi i PPM-ve dhe masat e shëndetit dhe sigurisë do të jenë të detyrueshme.
- Plani i menaxhimit të trafikut - kontraktorët do të zbatojnë masa për të parandaluar aksidentet rrugore, për të siguruar sinjalistikën dhe koordinimin me komunat, si dhe për të minimizuar ndërprerjet gjatë aktiviteteve të dorëzimit të pajisjeve dhe hapjes së kanaleve të kablllove.
- Masat për rivendosjen e mjeteve të jetesës - edhe pse projekti është i kufizuar kryesisht në nënstacionet dhe të drejtat e kalimit ekzistues, çdo kufizim i përkohshëm i qasjes apo ndërprerjeje ekonomike do të zbutet nëpërmjet ofrimit të qasjes alternative, rivendosjes së shpejtë të funksionimit dhe kur është e aplikueshme, kompensimit të drejtë duke ndjekur parimet e KP5 të BERZH-it.

Korniza e menaxhimit social të projektit siguron që aktivitetet e ndërtimit dhe operimit do të zhvillohen në mënyrë të sigurt, të drejtë dhe të përgjegjshme, duke rezultuar në përmirësim të infrastrukturës lokale, mundësi punësimi dhe rritje të besimit të komunitetit.

## 5.11 Trashëgimia kulturore

Projekti nuk pritet të ketë ndikim të rëndësishëm në trashëgiminë kulturore. Nëse zbulohen objekte të trashëgimisë kulturore, ndërtimi do të ndalet menjëherë dhe autoritetet përkatëse do të njoftohen për të zbatuar mbikëqyrjen e duhur dhe masat korrigjuese.

# 6 Monitorimi i ndikimeve

Një program i qëndrueshëm dhe sistematik monitorimi është thelbësor për të siguruar që masat zbutëse mjedisore dhe sociale, si dhe planet përkatëse të menaxhimit, të zbatohen në mënyrë efektive. Ky kapitull përshkruan kornizën për monitorimin e ndikimeve, angazhimin me palët e interesit gjatë gjithë ciklit të jetës së projektit dhe trajtimin e çdo çështjeje që mund të paraqitet.

## 6.1 Procesi i monitorimit

Një kornizë e strukturuar e monitorimit mjedisor dhe social do të zbatohet gjatë gjithë projektit, me qëllim që të sigurohet menaxhimi efektiv i të gjitha ndikimeve të identifikuara mjedisore, të shëndetit dhe sigurisë, si dhe atyre sociale, dhe që masat zbutëse të mbeten të përshtatshme dhe funksionale. Aktivitetet e monitorimit do të bazohen në planin e menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS) dhe në planin e veprimit mjedisor dhe social (PVMS) të zhvilluara për projektin. KOSTT do të kryejë mbikëqyrje të vazhdueshme të kontraktorëve dhe aktiviteteve në kantier për të verifikuar pajtueshmërinë me legjislacionin kombëtar, kërkesat e performancës së BERZH-it dhe planet e menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS) specifike për lokacionin. Rezultatet e monitorimit do të përdoren për të përshtatur masat e menaxhimit kur është e nevojshme dhe për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm në të gjitha nënstacionet dhe lokacionet e projektit.



Inspektive të rregullta dhe marrje mostrash mjedisore do të kryhen në nënstacione dhe përgjatë linjës së re nëntokësore të transmetimit midis Prizren 1 dhe Prizren 2. Gjetjet do të raportohen përmes raporteve tremujore të monitorimit dhe do të ndahen me menaxhmentin e KOSTT-it, inxhinierin mbikëqyrës dhe BERZH-in.

## 6.2 Konsultimi i vazhdueshëm dhe mekanizmat e reagimit

Angazhimi i palëve të interesit do të vazhdojë gjatë gjithë zbatimit të projektit përmes takimeve koordinuese me komunat dhe sesioneve informuese për komunitetet lokale. Mekanizmi për trajtimin e ankesave do të mbetet aktiv për të mbledhur dhe trajtuar menjëherë komentet dhe ankesat. Reagimet do të integrohen në menaxhimin e projektit dhe do të raportohen në mënyrë të rregullt tek BERZH në kuadër të raporteve periodike të progresit.

## 6.3 Adresimi dhe trajtimi i çështjeve të reja

Çdo çështje e identifikuar gjatë monitorimit ose e ngritur përmes ankesave të komunitetit do të regjistrohet, vlerësohet dhe trajtohet përmes mekanizmit për trajtimin e ankesave (MTA) të projektit, siç përcaktohet në planin e angazhimit të palëve të interesit (PAPI). MTA-ja është një mekanizëm i qashtëm, transparent dhe pa kosto, i krijuar nga KOSTT për të pranuar dhe zgjidhur ankesat që lidhen me ndikimet mjedisore dhe sociale të projektit. MTA-ja është e disponueshme për të gjithë personat e prekur nga projekti, komunitetet dhe punëtorët, dhe mund të përdoret përmes disa kanaleve, përfshirë telefonin, postën elektronike, faqen zyrtare të KOSTT-it, rrjetet sociale dhe dorëzimin fizik të formularëve të ankesave (formulari do të jetë i disponueshëm në gjuhën shqipe, serbe dhe, sipas nevojës, në gjuhë të tjera të komuniteteve).

Të dhënat e kontaktit dhe procedurat e MTA-së publikohen në faqen zyrtare të KOSTT-it, në formularët e ankesave dhe në materialet informuese të shtypura, në përputhje me PAPI-in.

### Informacione kontakti për dorëzimin e ankesave dhe kërkesave

**Emri dhe pozita:** Minivere Idrizi

**Adresa:** KOSTT: Rr. Isa Boletini. Nr. 39, 10000 Prishtinë, Kosovë

**E-mail:** minivere.idrizi@kostt.com

**Telefoni:** + 383 (0)38 501 301 049

Procedurat, hapat dhe afatet kohore të MTA-së përshkruhen në PAPI dhe u komunikohen palëve të interesit. Ankesat serioze ose të përsëritura do të përshkallëzohen për shqyrtim nga njësia mjedisore dhe sociale e KOSTT-it dhe, kur është e nevojshme, konsulentët e jashtëm do të ofrojnë mbështetje teknike për të siguruar që masat e duhura korrigjuese të zbatohen.